



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2495, datë 14.08.2014

Për

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Anilda Mulgeci, në mbledhjen e datës 14.08.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Pika 10 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 68, dhe neni 69 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), i ndryshuar;

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2413, datë 27.01.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” ”.
5. Urdhër Nr.1230 datë 18.06.2014 për “Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentave të përfundimit të këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Propozimi i hartuar nga grupi i punës
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Dokumentacioni për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- përfundimet e këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800”;
- propozimin e AKEP për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.2413, datë 27.01.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” ”.

V E N D O S:

1. Të miratojë **përfundimin e këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800”**, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e palëve të interesuara, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit, si dhe qëndrimin e AKEP për çështjet e ngritura sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

Komentet e pjesemarrësve në keshillimin publik "Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800"


Ne zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2413, datë 27.01.2014 për "Miratimin e dokumentit për keshillim publik "Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800" ", AKEP kreu një keshillim publik me palet e interesuara. Në përfundim të këtij keshillimi publik, në AKEP u depozituan katër komente nga pale të interesuara:

Me poshtë paraqiten komentet e të interesuarve dhe qëndrimi përkatës i AKEP.

AKEP kishte propozuar dy skenare për shfrytëzimin e spektrit:

SKENARI 1 - Cdo operator do të fitojë të drejtën e përdorimit 6 MHz spekter frekuencash shtesë, me kanale sigurie midis tyre 200 KHz duke ndarë bllokun e lirë 25.2 MHz. Kështu bëhet e mundur që të katër operatorët të kenë në përdorim 2x15 MHz (9 + 6 MHz), por jo në një bllok.


GSM 1800



Cdo operator do të fitojë të drejtën e përdorimit 6 MHz spekter frekuencash shtesë, me kanale sigurie midis tyre 200 KHz

SKENARI 2 - Spektri rindahet midis operatorëve në blloqe 2x15 MHz duke humbur të drejtën e përdorimit aktual për 2x9 MHz dhe secili rifiton të drejtën e përdorimit të bllokut 2x15 MHz frekuencash të çiftuara. Midis blloqeve përdoren kanale sigurie 200 KHz.

GSM 1800



Spektri rindahet midis 4 operatorëve në blloqe 2x15 MHz secili. Kanale sigurie 200 KHz midis blloqeve.

Komentet e operatoreve ishin si me poshte:

Operatori 1 mbeshtet skenarin e dyte, propozuar nga AKEP ku:

Secilit operator i krijohet mundesia per te marre edhe 6MHz brez te ri (pra 15MHz ne total) dhe lenien e lire te nje brezi prej 15MHz (12,6MHz). Operatori 1 do te deshironte te shprehte pikepamjen e vet ne drejtim te optimizimit te ketij skenari, gjithmone duke u bazuar ne parimet e barazise dhe transparences, konkretisht sipas dy varianteve qe jepen ne vazhdim: Vendosja e te gjithë brezit te bandes 1800MHz ne dispozicion te operatoreve aktuale ne menyre te barabarte (pra - 18.5MHz per secilin);

Vendosja e gjithë brezit te bandes 1800MHz ne dispozicion te operatoreve aktuale me ndarjen respektivisht 20MHz per tre operatore dhe 15MHz per operatorin e katert (duke mundesuar shtesen prej 5MHz nga nje bande tjeter).

Operatori 1 mbeshtet nje nga dy varjantet e mesiperme nisur pike se pari nga gjeresia e brezit te nevojshem per sigurimin e sherbimeve te reja, ne menyre te vecante atij LTE. Kjo bazuar jo vetem ne rekomandimet nderkombetare, por ne menyre te vecante ne eksperiencen e vendeve qe tashme kane implementuar teknologjite 2G/3G/LTE ne kete brez. Operatori 1 sugjeron sa me poshte:

Te mbahet ne konsiderate se tendenca baze e zhvillimit te rrjeteve (kjo bazuar fuqimisht ne kerkesat e perdoruesve) eshte sigurimi i nje shpejtesie sa me te larte.

Implementimi i teknologjise LTE tashme eshte bere realitet dhe mund te konsiderohet edhe LTE-ja si nje kerkese reale. Shpejtesia e siguruar nga rrjeti 3G (42Mb) eshte tashme prezente ne vendin tone. Implementimi i teknologjise LTE presupozon sigurimin e nje shpejtesie me te larte se ajo e rrjetit 3G, ne te kunderten nuk do te jete ne interesat e operatoreve dhe te perdoruesve, gjithashtu. Perdorimi i brezit 1800MHz per sherbimin LTE tashme eshte jo vetem nje standard por eshte bere nje fakt pothuajse ne te gjithë vendet. Bazuar sa me siper Operatori 1 sugjeron se:

Brezi minimal per te filluar ofrimin e sherbimit LTE duhet te jete 5MHz. Brez ky qe do te lejonte arritjen e nje shpejtesi rreth 2 here me te madhe se e rrjetit 3G.

Optimizimi i investimeve eshte i mundshem te realizohet ne rastin e perdorimit te ketij brezi. Gje kjo qe do te lejonte operatorin te planifikonin me mire dhe me shpejt investime te tilla. Duhet te theksojme se perdorimi i nje brezi me te larte (psh. 2.6 GHz) eshte i mundshem, por investimet e nevojshme do te rriteshin ne menyre te konsiderueshme. Eksperienca e shume operatoreve e ka vertetuar kete gje. Tashme mund te themi se zhvendosja e rrjeteve te ndertuara fillimisht ne 2.6 GHz drejt brezit 1800 MHz eshte nje fakt.

Duke konsideruar se bashkejtesa e rrjeteve 2G/3G/ do te vazhdoje edhe per nje kohe te gjate, Operatori 1 sugjeron se nje brez fillestar prej 20MHz ne kete bande do te jete nje zgjidhje oportune si per AKEP-in ashtu edhe per operatorin. Kjo do te jete edhe nje nxitje per te filluar implementimin e teknologjise se re LTE ne vendin tone.

Operatori 1 sugjeron ketu gjithashtu se nuk eshte i nevojshem parashikimi i kanaleve te sigurise prej 2 x 200 kHz. Sipas praktikese se viteve te fundit ne shume vendeve te tjera, autorizimet jepen ne blloqe ne MHz te plote dhe ne licensen perkatese shprehet se nese operatorin do te perdorin GSM, ata nuk mund te perdorin kanalet e sigurise prej 2 x 200 kHz te licences se tyre. Nese operatorin perdorin UMTS, LTE apo WiMAX, ata duhet te

perdorin "block edge masks ", te cilat japin te njejtin rezultat sipas te cilit nuk mund ta perdoresh te gjithë fuqine ne kufirin e bllokut. Operatori 1 kerkon shperndarjen ne menyre te barabarte mes operatoreve te gjithë spektrin GSM 1800 MHz duke mos lene asnje bllok te lire, bazuar ne argumentat e meposhtme:

- Sasia e spektrit e propozuar per dhenie nga AKEP ne blloqe 2x15 MHz, nuk eshte e mjaftueshme per zbatimin e parimit te neutralitetit te teknologjise dhe ofrimin e teknologjive te tjera. Konkretisht, ne 15 MHz Operatori 1, mund te ofroje sherbime ne teknologjine LTE ne te njejten cilesi me ofrimin aktual te teknologjise 3G.
- Nuk ka asnje arsye per lenien rezerve te nje sasie te caktuar spektri , pasi sic edhe shihet nga tendeneat e tregut, nuk eshte i mundur operimi ne treg i me shume se 4 operatoreve te sherbimeve te levizshme.
- AKEP mund te vere kushte ne autorizimet e 4 operatoreve qe nese ne nje te ardhme mund te kete kerkese per spekter nga operatore te rinj hyres ne treg, te kete rivleresim te spektrit ne perputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe konkurrences ne treg. Operatori 1 deshiron te theksoje se edhe ne rast se AKEP do te vendose te lere te lire brezin prej 12.6MHz (15MHz) duhet qe (nje brez i tille eshte shume i nevojshem per zhvillimin e rrjeteve te reja, LTE), te jepen shpjegime te qarta per strategjine e perdorimit ne vazhdim te ketij brezi si dhe te behen argumentimet perkatese. Kjo do ti beje me te lehte dhe me te qarte vendimet e operatoreve per investimet respektive lidhur me teknologjine e re.

Operatori 1, kerkon te vazhdoje perdorimin e ketij spektri duke i shtuar pjesen shtese brezit ekzistues.

Operatori 2 eshte dakort vetem me Skenarin Nr.1, ku cdo operator te fitoje te drejten e perdorimit 6 MHz spekter frekuenca shtese dhe kanale sigurie midis tyre 200 KHz.

Skenari Nr.2 ku spektri rindahet/rifarming , kerkon nje proces spostimi per cdo operator. Ky proces mund te rezultoje i nderlikuar dhe i kushtueshem si dhe mund te gjeneroje pasoja ne mirefunksionimin e sistemit gjate implementimit te ketij ndryshimi dhe migrimit ne brezin e ri te gjithë rrjetit te aksesit.

Ne kushtet aktuale ku ndjeshmeria e perdoruesve eshte e larte ndaj cilesise se sherbimit dhe stabilitetit te saj, Operatori 2 eshte kategorikisht kunder implementimit te skenarit Nr. 2.

Operatori 3 nuk shprehet dakord me ndarjen e propozuar dhe sasine e spektrit te dhene per perdorim secilit operator.

Nxitja e perdorimit efikas te spektrit te fekuencave.

Spektri i radio frekuences eshte nje burim i kufizuar/fundem natyror me vlera te medha ekonomike per Shqiperine. Per kete arsye, perdorimi efikas i spektrit te radio frekuences eshte nje nga objektivat kryesore rregullatore te percaktuara nga Ligji 9918, date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike dhe postare" ("Ligji 9918/2008"). Neni 62 i Ligjit 9918, date 19.05.2008 parashikon se administrimi i spektrit duhet te garantoje perdorim efektiv dhe te frytshem ne perputhje me vendimet perkatese te organizatave nderkombetare dhe detyrimet e parashikuara ne konventat apo marreveshjet ku Shqiperia ka aderuar. Pra, promovimi i perdorimit efikas te spektrit te radio frekuences dhe mbrojtja e interesit publik jane elemente kryesore qe AKEP duhet te mbaje parasysh

ne administrimin e spektrit te radio frekuencave dhe vendimet ne lidhje caktimin, transferimin, monitorimin apo terheqjen e te drejtave per perdorimin e spektrit te radio frekuencave nga sipermarresit e komunikimeve elektronike.

Faktoret nxites per sfidat ndaj rritjes se trafikut ne broadband nepermjet rrjeteve te Levizshem Trafiku celular me brez te gjere eshte rritur ndjeshme ne vitet e fundit. Kjo ka ardhur si pasoje e zgjerimit dhe zhvillimit te pajisjeve te reja te levizshme qe shfrytezojne kapacitetin brezgjere telefonat smart, tabletat, modems - nepermjet te cileve konsumatorët kane akses te aplikacione komplekse, video HD, rrjete sociale me permbajtje te larte multimediale dhe trafik M2M (machine to machine), te gjitha keto qe shfrytezojne maksimalisht kapacitetin brezgjere.



Huawei Spektri i plote i mundesive, Gusht 2013

Qasja simetrike ndaj asaj asimetrike.

Deri me tani AKEP ka caktuar sasi te njejta spektri (qendrimi simetrik) ne brezat 900MHz dhe 1800MHz, si rezultat i politikave jo diskriminuese qe AKEP zbaton per te gjithë operatorët ne treg. Ky spekter eshte caktuar per GSM qe ka per baze kanalet prej 2x200kHz. Pavaresisht kesaj, per teknologjite 3G dhe 4G nevojiten blloqe me te medha spektri te vazhdueshem, zakonisht nje shumatore te brezave prej 2x5MHz. Ne Shqiperi, i gjithë spektri qe do te tenderohet ne te ardhmen do te liberalizohet dhe prandaj permasat e blloqeve duhet te jene te tilla per te permbushur nevojat e cfaredo lloj teknologjie. 5 MHz eshte sasia minimale e spektrit qe kerkohet per te garantuar zhvillimin e cdo lloj teknologjie me spektrin e dhene. Ne brezin 1800MHz. teknologjia qe duhet te perdoret ne te ardhmen eshte teknologjia LTE.

Operatori 3 ve theksin tek nevoja per te lehtesuar prezantimin e teknologjive te reja qe

mundesojne sherbime inovative, efikasitet me te larte te spektrit dhe krijimin e mundesive per bashke-ekzistencen e "sherbimeve radio" te ndryshme ne te njejten brez frekuence. Sistemet e reja broadband si LTE kerkojne blloqe me te medha spektri se ate me te cilat jemi pershtatur ne te shkuaren. Ndarja e te njejtin brez ndermjet te gjithë operatoreve do te rezultojne ne fragmentim te tepruar dhe perdorim jo eficient nga te gjithë aktoret. Me licensimin e spektrit do te duhet te pranohet ne te ardhmen se jo te gjithë operatorët mund te ndajne te njejtin sasi brezi me te njetin efikasitet (qendrimi asimetrik). Per me teper, ne periudhen afat gjate do te jete e nevojshme te jepet spekter shtese per sherbimet celulare. Eksperienca dhe parashikimet tregojne rritje te jashtezakonshme te sherbimeve celulare data (te dhena) duke qene se konsumatorët gjithmone e me shume kerkojne telefona inteligjente me te perparuar, tableta me lidhje ne internet. libra elektronike dhe internet me brez te gjere ne kompjuterat e tyre portabel. Nevoja ne rritje per te zgjeruar kapacitetin per sherbime celulare me brez te gjere eshte nje faktor vecanerisht i rendesishem per teknologjine LTE, per te cilen nevojiten kanale prej 20MHz qe ajo te arrije performance e plote te mundshme.

Operatori 4 mbeshtet qellimin e AKEP per te pregatitur tregun celular per implementimin e teknologjive te ardhshme. Gjithashtu duhet theksuar se regjimi aktual i licensimit te brezit 900 MHz dhe 1800 MHz eshte nje reflektim i "epokes GSM". Kjo do te thote se dhena aktuale e se drejtes se perdorimit eshte pershtatur ne menyre te persosur per te administruar trafikun GSM. Ne rastin e Operatorit 4, dhena e te drejtes se perdorimit eshte afersisht ekuivalente me spektrin e kerkuara per rrjetin GSM, megjithese ne menyre ideale Operatori 4 duhet te kishte akses ne me shume sasi spektri GSM per te permiresuar kapacitetin dhe cilesine e sherbimeve te saj GSM. Keshtu, opsioni 1 i propozuar nga AKEP do te ishte nje menyre e vlefshme per te permiresuar poziten e spektrit te Operatori 4, nese do te merrej ne konsiderate vetem rrjeti GSM. Fakti qe spektri shtese nuk do te ishte prane bllokut te spektrit qe disponon aktualisht Operatori 4 (ne brezin 1800 MHz) nuk do te perbente problem per rrjetin GSM, pasi ky i fundit nuk kerkon nje bllok spektri te afert per te funksionuar ne menyre efikase.

Megjithate, duke qene se qellimi i AKEP eshte liberalizimi i kushteve te perdorimit te spektrit per te mundesuar implementimin e teknologjive ne brez te gjere 3G dhe 4G ne brezin e frekuencave 900/ 1800 MHz, panorama e pershkruar me lart ndryshon rrenjesisht: Rrjetet UMTS dhe LTE nuk kerkojne nje bllok spektri te afert per te funksionuar ne menyre eficiente. Me saktesisht, rrjetit UMTS i nevojiten blloqe 5 MHz ndersa rrjeti LTE cilesohet se punon ne nje shumellojshmeri brezash frekuencash, prsh. 3 MHz, 5 MHz, 8 MHz, 10MHz, 15 MHz ose 20 MHz. Rrjeti LTE cilesohet me tej se punon ne disa breza spektrash, por me zakonisht (ne Europe) implementohet ne brezin 800 and 1800 MHz. Teksa brezi 1800 MHz pedoret aktualisht per rrjetin GSM, kjo do te thote qe alokimi i spektrit qe t'i rezistojne te ardhmes ne kete brez duhet te jete kompatibel me rrjetin GSM dhe LTE gjithashtu. Nje alokim i tille i spektrit duhet te lejojte gjithashtu per nje shkallezim fleksibel te brezit te frekuencave per rrjetin GSM dhe LTE sipas ndryshimit te kerkeses. Me specifikisht, ne nje periudhe te shkurter kohore, nje pjese e caktuar e spektrit duhet te rezervohet per te mbeshtetur rrjetin GSM, ndersa pjesa tjeter mund te perdoret per rrjetin LTE.

Me kalimin e kohes, me rritjen e trafikut ne rrjetin LTE, gjeresia e brezit te nevojshem per rrjetin LTE do te duhet te rritet proporcionalisht (ndersa spektri per GSM te reduktohet sipas rrethanave), deri ne kohen kur i gjithe spektri 1800 MHz i disponueshem do te perdoret ekskluzivisht per rrjetin LTE. Per te mbeshtetur nje skenar te tille, spektri qe disponohet nga nje operator i caktuar duhet te perbehet nga nje bllok i vetem i afert i spektrit, dhe do te ishte ideale ne masen 20 MHz (por te pakten 15 MHz). Duhet te theksohet me tej se per shkak te numrit te ndryshem te abonenteve, jo te gjithe operatoret do te kene te njejten kerkese per spekter. Keshtu, disa operatoreve mund tu nevojitet me pak kapacitet spektri 1800 MHz se te tjeret, dhe nuk eshte e nevojshme nje ndarje simetrike e spektrit. E kunderta ndodh ne kete rast: Nje treg i lire konkurrues me asetete te ndryshme te spektrit te operatoreve te rrjetit celular eshte nje shenje spektrash dhe strategji rrjeti te ndryshme.

Per kete arsye, skenari 1 dhe 2 i propozuar nga AKEP jane tashme nje hap perpara ne drejtimin e duhur duke qene se parashikojne rritjen e zoterimit te spektrit nga te gjithe operatoret. Megjithate, edhe skenari 2 nuk paraqet nje zgjidhje optimale nga perspektiva e tregut. Se pari, ai nuk eshte efikas pasi ka te pacaktuara burimet e lira te spektrit. Se dyti, edhe nese spektri i pacaktuar do te vihet ne dispozicion ne nje faze te mevonshme, vetem nje operator (dmth, ai qe mban bllokun e spektrit ngjitur me spektrin qe eshte aktualisht i pacaktuar) mund te realizoje perdorimin optimal te tij, ndersa per te gjithe operatoret e tjere, nje bllok shtese i spektrit, qe nuk eshte ngjitur me bllokun e tyre ekzistues do te nenkuptonte nje dizavantazh te konsiderueshem. Per kete arsye, do te kishim te benim me nje situatete diskriminuese qe do te conte ne shtremberim te tregut.

Se treti, sic pershkruhet me siper nje shperndarje simetrike e spektrit ne te gjithe brezat nuk eshte e nevojshme per te siguruar shanse te barabarta dhe konkurrese dinamike mes lojtareve perkates te tregut. Shifra te ndryshem abonentesh dhe strategji jo te barabarta te sipermarresve lejojne nje devijim nga fokusi i lojtareve ne burimet aktuale dhe te ardhshme te spektrit (900/ 1800/2100 MHz) per te optimizuar rrjetet e tyre per strategjite e tyre specifike te biznesit. Pra, nuk ka asnje arsye pse te gjithe operatoret te kene ekzaktesisht te njejten sasi spektri ne cdo brez. Me sa dime ne, ne asnje vend tjeter ne Europe, te gjithe operatoret nuk zoterojne te njejten sasi spektri ne tre brezat e ndryshem te frekuencave. Spektri i disponueshem ne brezin 1800 MHz ne Shqiperi do te lejonte prsh. dy operatore qe te kishin akses ne brezin 1800 MHz ne te pakten nje bllok 20 MHz, nderkohe qe dy te tjeret mund te zgjidhnin akses ne kete brez ne nje bllok mes 10-15 MHz. Kjo gje do te bente qe tregu te kishte serish ne kete moment nje ndarje relativisht te balancuar te spektrit. Zgjerime te metejshme te spektrit te disponueshem per brezin e frekuencave do te pasojne me dhenien e te drejtave te perdorit ne te ardhmen ne brezin 2100, 2600 dhe 800 MHz.

Ne propozojme nje rregullim te skenarit 2 sic tregohet ne figuren e meposhtme:

Ne propozojme nje riorganizim te vendndodhjeve ekzistuese te spektrit 1800 MHz per te krijuar blloqe te aferta 5-20 MHz, gje e cila do te krijonte vend per te gjithe operatoret qe te rrisnin kapacitetet e tyre te spektrit ne blloqe te aferta 10, 15 madje dhe 20 MHz.

Nje organizim i tille i spektrit dhe te drejtave te perdorimit do te lejonte arritjen e objektivave te rendesishme te politikës te deklaruar ne faqen 9 te dokumentit per konsultim, sidomos perdorimin efikas dhe optimal te spektrit pa shkakuar interferenca

ne brezin 1800 MHz. Duke marre ne konsiderate zoterimet aktuale te spektrit, numrin e abonenteve dhe nevojën për spekter, propozimi është i drejtë dhe jo-diskriminues dhe i le vend për rritje dhe novacion nga ana e të gjithë sipërmarrësve.

Ne propozojmë që të vazhdohet me shpërndarjen ekzistuese të spektrit në brezin 900 MHz me qëllim që të garantohet mbrotje dhe operimi i vazhdueshëm i rrjeteve GSM në këto brez. Ashtu si edhe në vendet e tjera Europiane, ne presim që rrjetet GSM900 të vazhdojnë të jenë ende për një periudhë të konsiderueshme kohe infrastruktura kryesore për telefoninë celulare që siguron komunikime celulare private dhe komerciale në të gjithë vendin, sidomos thirrje emergjence. Gjithashtu, rëndësia e tij po rritet aktualisht për zhvillimin e sistemeve të komunikimit M2M me gjerësi brezi shumë të kufizuar.

Komenti i AKEP:

Do të vazhdojë procedura për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX sipas ndarjes së mëposhtme:

Të drejtat e përdorimit	Sasia e spektrit
A	2x6 MHz spektër i çiftuar, 1738.4 -1744.2 MHz
B	2x6 MHz spektër i çiftuar 1744.6-1750.4 MHz
C	2x6 MHz spektër i çiftuar 1760-1765.8 MHz
D	2x6 MHz spektër i çiftuar 1766.2-1772MHz
E	2x6 MHz spektër i çiftuar 1772.4-1778.2 MHz
F	2x6 MHz spektër i çiftuar 1778.6-1784.4 MHz

Pyetja për procedurën:

Për procedurën që do ndiqet, jeni dakort të vazhdohet sipas procedurës së percaktuar me VKM Nr.1252, 10.9.2008, i ndryshuar, apo zbatimin e një procedure tjetër?

Operatori 1 gjykon se procesi i ri i shperndarjes se spektrit duhet te shoqerohet me nje procedure administrative per alokimin e frekuencave (perfshire edhe shtesen e spektrit) pa ndermarre procedura te tenderimit publik pasi ne kete rast ceshtja nuk shtrohet se cili operator do te fitoje te drejtat e perdorimit mbi nje brez te caktuar per te cilin do te konkurrohet per procesin e rishperndarjes se spektrit udhehiqet nga parimi i neutralitetit te teknologjise ne zbatim te te cilit operatoret do te mund te ofrojne sherbime dhe teknologji UMTS dhe LTE mbi brezat ekzistues te GSM 900 MHz dhe 1800 MHz. Ne te njejten kohe, ky proces shoqerohet edhe me shperndarjen dhe alokimin e brezit te lire te frekuencave (te pa alokuara) te cilat ne rrethanat e ofrimit te ketyre sherbimeve te reja, jane te domosdoshme te shperndahen tek te gjithë operatoret ne menyre te barabarte dhe te plote per te garantuar keshtu cilesine e sherbimeve. Nderkohe qe sipermarresit do te jene ne vazhdimsi subjekt i pagesave vjetore per brezat e frekuencave ekzistues ashtu edhe per ato qe do t' i shtohen secilit operator. Duke iu referuar edhe praktikave te vendeve te Europes te cilet e kane ezauruar tashme procesin e "refarming" dhe per te cilat Cullen International ka bere nje monitorim te posaçem, verehen raste te ngjashme me rastin e Shqiperise sic eshte rasti i Lituane ku spektri ne 900MHz dhe 1800 MHz eshte rishperndare dhe eshte lejuar te perdoren sherbimet GSM, UMTS dhe LTE si dhe te tre operatoreve mobile u eshte dhene spekter shtese dhe nuk rezulton qe asnje nga keta operatore te kene paguar ndonje pagese (one time fee) per caktimin e ketyre frekuencave shtese.

Operatori 2: Lidhur me proceduren per alokimin e brezave, ne kushtet kur vetem Operatori 2 nuk eshte pajisur me Autorizim Individual 3G, por gjithashtu ne funksion te nje politike rregullatore bazuar ne peshen specifike te operatoreve mobile ne tregun shqiptar, eshte domosdoshmeri nje progedure e re, e aplikuar direkt nga AKEP, qe ti referohet teresisht konkluzioneve te Analizes se Tregut per operatoret mobile ne Shqiperi.

Operatori 3: Aktualisht Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 1252. date 10.09.2008 "Per miratimin e rregullave per proces te hapur ofertash ne lidhje me te drejten e perdorimit te frekuencave" parashikon per dhenien ne perdorim te spektrit proceduren e ankandit permes nje raundi te vetem ofertash te mbyllura. Nese qeveria vendos te jape vetem nje license per spekter ne nje kohe te caktuar. Operatori 3 eshte dakord per dhenien ne perdorim te spektrit te ri nepermjet procedures se ankandit. Operatori 3 sugjeron se Vendimi i Keshillit te Ministrave duhet te amendohet per te parashikuar edhe mundesine per proces tenderi per paketa produktesh (*Combinatorial Clock Auction*) ose nje proces tenderi me disa raunde te njekohesishme me cmim ne rritje (SMRA)!. Duke mundesuar dhenien ne perdorim te disa blloqesh spektri njekohesisht dhe duke i dhene mundesine ofertuesve te ndryshojne ofertat e tyre ne cdo raund. Zakonisht ndryshimi i ofertave synon rritjen e vleres se ofertes qe eshte dhe nje mundesi per Qeverine qe te maksimalizojte te ardhurat e buxhetit te Shtetit nga dhenia ne perdorim e spektrit.

Ne pergjithesi, **Operatori 4** propozon qe procedura per caktimin e spektrit ne Shqiperi te ndjehet gjithashtu edhe parimet standarte te parashikuara ne Rregulloren e Bashkimit Evropian per telekomunikimet, lidhur me organizimin e shitjes se spektrit. Se pari,

nevojitet qe autoritetet kombetare ti kushtojne rendesi trajtimit objektiv, transparent dhe jo-diskriminues te te gjitha operatoreve te perfshire ne proces. Se dyti, procedurat e caktimit te spektrit nuk duhen keqperdorur per te permiresuar buxhetin e shtetit. Se treti, tarifate perkatese nuk duhen paguar paraprakisht por ne momentin qe operatoret jane ne menyre efikase te afte te shfrytezojne spektrin. Keto parime jane aktualisht pjesa baze e rregullores te Komisionit Evropian "Kontinent i lidhur" qe pritet te dale ne vijim. Ne lidhje me proceduren e percaktuar me VKM Nr.1252, date 10.9.2008, i ndryshuar, persa i perket Kapitullit I , paragrafi 1.1, ne propozojme qe agjensia te mos kufizojte caktimin e spektrit vetem ne situata pamjaftuesmerie, duke patur me shume kerkesa sesa ofrim te spektrit te lire. Fokusi kryesor per rregulloren e caktimit te spektrit duhet te jete ofrimi i te gjitha burimeve te disponueshme per tregun e komunikimeve elektronike, te cilat nevojiten per te siguruar cilesine e sherbimit si dhe per te mbeshtetur rritjen, risite dhe implementimin e teknologjive te reja. Pra, dhenia e te drejtes se perdorimit te spektrit pas nxitjes se interesit publik duhet te jete i mundur edhe ne rast se ka me shume burime sesa kerkesa, ne ate pike te kohes. Kjo gje eshte ndryshuar tashme tek rregullat ne Kapitullin III, perkatesisht paragrafet 21.1 dhe 21.2, permes Vendimit nr. 501 te dates 9.06.2010, dhe eshte mirepritur.

Lidhur me paragrafin 1.3, duhet theksuar se: ndersa ofrimi publik i spektrit te lire dhe nxitja e interesit te agjensise mund te coje ne nje situate ku ka me shume se nje pale te interesuar, duhet te mundesohet gjithashtu edhe dhenia e te drejtes se perdorimit te pjeseve te spektrit me shume se nje operatori. Keshtu, procedura konkurruese e tenderit mund te coje ne me shume se nje fitues te tij.

Persa i perket procedurave qe pershkruhen ne Kapitullin II, paragrafi 1 i Vendimit, si dhe specifikave ne Kapitullin III paragrafi 4, duhet theksuar se ne propozojme qe te parashikohet nje faze parakualifikuese perpara dhenies se te drejtes se perdorimit te spektrit. Nje kusht i rendesishem per te patur vendime te sukseshme per dhenien e te drejtes se perdorimit te spektrit si dhe perdorim efikas dhe te vazhdueshem te tij, eshte venia ne funksion e nje procedure intensive para-kualifikimi qe kerkon vecanerisht pervoje ne projektim dhe mirembajtje rrjeti si dhe ne krijim sherbimesh (sic edhe parashikohet ne Kapitullin 5.1). Gjithashtu nevojitet, sic edhe parashikohet ne Vendim, qe te sigurohen kapacitetet e mjaftueshme financiare per te paguar licensat dhe kostot e lancimit (te sherbimeve). Palet e interesuara, te cilat nuk jane te kualifikuara mjaftueshem mund te cojne ne perdorim jo efikas te spektrit, dhe mund te crregullojne procedurat. Lidhur me paragrafin 4.4, Operatori 4 deshiron te propozoje qe ky paragraf te hiqet, pasi tregu i telefonise celulare ne Shqiperi eshte i tej-ngopur duke patur kater operatore te rrjeteve GSM. Duke i pare gjerat ne kendveshtrimin e rritjes se kerkeses per spekter nga operatoret perkates, nevojitet qe AKEP te parashikojte shtrirjen e kapaciteteve per cdo spekter GSM qe ka mbetur i lire. Lidhur me mundesine e ndryshimit te mevonshem te rregullave dhe dhenies se te drejtes se perdorimit te spektrit, pershkruar ne Kapitullin III, paragrafi 6.2, ne propozojme qe te shtyhet afati kohor per dorezimin e ofertave per me shume se 5 dite. Nese ndryshimet perfshijne kushte te rendesishme te cilat do te kerkonin rillogaritjen dhe procese te reja aprovimi nga ofertuesit e interesuar, atehere koha minimale shtese duhet te jete te pakten 10 dite pune. Ne lidhje me Kapitullin II, paragrafi 9.1, propozohet te hiqet fjalia e fundit per te siguruar si nje implikim te parimeve baze te transparences dhe barazise ndaj

rezultateve dhe fituesit te tenderit. Kjo gje rekomandohet si nje dryshim ne paragrafin 15.8, si alternative e pjeses se procedures aktuale te parashikuar ne proces. Kjo pjese do te perdorej vetem nese data dhe koha e vules do te ishin identike. Persa i perket Kapitullit III, paragrafi 10.7 b, ne rekomandojme qe ofertuesi, ne pergjithesi, te marre nje vertetim marrje me daten dhe kohen e ofertes se tyre. Ne rastin e ofertave me shuma identike lidhur me nje bllok specifik spektri, data dhe koha e vules se dorezimit duhet te perdoret si baze objektive per vendimin qe do te merret per bllokun perkates.

Komenti AKEP:

AKEP do te vazhdoje procedure e dhenies ne perdorim te frekuencave sipas ndarjes se mesiperme bazuar ne VKM 1252, e ndryshuar.

Pyetja mbi vleren:

Cila eshte vlera qe jeni te gatshem te paguani per Autorizimin Individual me ndryshimin e kushteve te brezit 900/1800 MHz, per lejimin e implementimit te teknologjive te reja ne keto breza?

Operatori 2: Lidhur me vleren e Autorizimit Individual per spektrin shtese 900/1800 por edhe per cdo lloj brezi frekuencash qe alokohen, Operatori 2 shpreh qendrimin sa me poshte se: Vlera e brezit te frekuencave duhet te jete funksion i sasise se spektrit po aq sa dhe peshes specifike qe cdo operator ka aktualisht ne treg (kur ky brez jepet ne te njejten kohe per operatoret) si edhe nje koeficient kohe kur jepet ne kohe te ndryshme. Pra, Operatori 2 kerkon, qe ky cmim te jete i diferencuar, ne menyre absolutisht propocionale me "market share" qe aktualisht ka secili nga operatoret mobile ne treg.

Operatori 3: Me rritjen e koheve te fundit dhe ate te pritshme te kerkeses per sherbime te komunikimit wireless, spektri radio. qe mund te perdoret per telekomunikacionet celulare eshte nje burim me vlere. Menyra se si caktohet spektri mund te kete impakt te konsiderueshem ne zhvillimin e tregjeve te ketyre sherbimeve.

Kerkesa per spekter si nje burim natyral nuk eshte direkte si eshte per shume produkte te tjera. Ajo vjen si pasoje e kerkeses per produkte dhe sherbime fundore qe prodhohen duke perdorur spektrin si baze. Ne rastin e komunikimeve celulare, jane konsumatoret e sherbimeve te komunikimit te cilet permes kerkeses se tyre per sherbime komunikimi krijojne kerkesen per spekter. Sa me e larte te jete kerkesa per sherbime komunikacioni, aq me e larte do te jete kerkesa per spekter nga operatoret celulare. Kerkesa per spekter eshte nje kerkesa derivate. Vleresimi i spektrit percaktohet ne nje mase te madhe nga kerkesa per te, e cila varet nga deshira dhe aftesia e paleve per te paguar nje pjese te madhe perdoruesish te spektrit apo operatore qe e perdorin ate si baze per prodhimin e sherbimeve te komunikimit. Sherbimet e telekomunikacionit kane evoluar ne menyre te konsiderueshme gjate 30 viteve te fundit. Nga gjenerata e pare e thjeshte e telefonise celulare zanore ne vitet 90' ne teknologjite komplekse 4G qe perbejne bazen e transmetimeve me ze dhe data. Me kalimin e kohes, konsumatoret kane rritur kerkesen e tyre per mbulim me te gjere, transmetim me te shpejte dhe me te avancuar si dhe

aplikacione celulare me volume te medha data. Per t'iu pergjigjur kesaj kerkese operatorët celulare kane perdorur relete radio me kapacitet te larte dhe me shtrirje te gjere qe kane per baze teknologjite me te mira ekzistuese duke rritur keshtu ne menyre te konsiderueshme kerkesen per spekter radio.

Ne nje kuptim me te gjere kerkesa per sherbime telekomunikacioni ndikohet nga elemente variabel te tille si prevalenca e tele-densitetit, ritmi i rritjes se GOP, perqindja e papunesise, norma e inflacionit, investimet ne infrastrukture dhe teknologji, karakteristikat sociale dhe ekonomike te grupeve te moshave ndryshme te popullise etj. Nese prevalenca e teledensitetit eshte e ulet, nuk ka kuptim te rritet penetrimi i sherbimit. Nje norme rritjeje me e larte e GOP do te conte ne menyre te padiskutueshme drejt kerkeses ne rritje per keto sherbime; perkatesisht perqindja ne rritje e papunesise dhe inflacionit ulin kerkesen per sherbime. Perdorimi i sherbimeve mund te ngadalesohet nese rritja ekonomike ngadalesohet dhe nese ulet ndjesia e mireqenies e individeve. Nese njerezit ndihen me te varfer per shkak te renies se te ardhurave ose rritjes se cmimeve kerkesa per sherbime telekomunikacioni do te bjere. Perspektiva per rritje ne te ardhmen ndikon edhe volumin e konsumit te sherbimeve te telekomunikacionit ne ekonomi. Nivelet e konsumit mund te ngrihen ne nje ekonomi me rritje te larte duke qene se njerezit parashikojne te ardhura me te larta ne te ardhmen. Kushtet konkrete si dhe potenciali i rritjes ekonomike mund te ndikojne vleren e spektrit. Autoritetet percaktojne shpesh nje cmim fillestar ne ankandet per spekter gje qe justifikohet me arritjen e nje ose me shume objektivave si me poshte:

- Te pengoje ofertuesit qe ofrojne vlere te vogla duke caktuar nje cmim fillestar i cili pengon ofertuesit jo serioze te marrin pjese ne tender, duke mundesuar qe procesi i tenderit te mbyllet me shpejt (dhe me nje kosto me te ulet);
- Te siguroje qe cmimi perfundimtar i ofertes do te mbuloje se paku kostot e administrimit dhe procesin e dhenies ne perdorim te spektrit;
- Te garantoje se vlere sociale e perftuar nga dhenia per perdorim e spektrit ne nje periudhe te mevonshme do te reflektohet ne cmimin perfundimtar te ofertes (p.sh. te siguroje qe spektri te mos jepet momentalisht nese vlere sociale e ruajtjes se spektrit per dhenie te mevonshme eshte me e madhe se sa vlere private e perftuar nga dhenia e spektrit ne kete moment); dhe
- Te kufizojte nxitjet per marrveshje te fshehta ndermjet ofertuesve potenciale.

Ne shumicen e rasteve, rregullatorët zgjedhin te perdorin benchmarke (metoda krahasimore) si baze per te percaktuar nje cmim te pershtatshem fillestar. Ky mund te jete rasti kur rregullatorët

nuk kane nje model per te matur vleren e spektrit ose ku kostot administrative ne lidhje me tenderin jane te paqarta. Ne zgjedhjen e benchmark-ut, rregullatori mund te zgjedhe ndermjet dy opsioneve:

- Ose te vendose cmimin fillestar sipas benchmark-ut te vendeve te tjera; ose
 - Te vendose cmimin final te ankandit sipas benchmark-ut te vendeve te tjera.
- sidoqofte, me zgjedhjen e skenarit te dyte rregullatorët duhet te pershtasin cmimin e benchmarkut per te konvertuar vlerat finale te spektrit ne cmim fillestar.

Shuma minimale qe duhet te paguaje nje ofertues per nje license edhe nese nuk ka konkurrence varet nga cmimi fillestar i caktuar per ankandin dhe tarifat vjetore pergjate kohezgjatjes se licenses. Operatori 3 gjykon se nuk duhet te caktohet nje cmim minimal

aq i larte sa qe te rrezikojte te 'mbyse' ofertat. Me qendrimin tone per caktimin e cmimit minimal ne fillimisht synojme te vendosim nje nivel minimal te pershtatshem duke perdorur benchmarke te pershtatshem dhe me pas te konsiderojme se cila eshte menyra me e mire per ta 'copezuar' ate ne nje pagese paraprake ne cmimin fillestar (i pagueshem pas procesit te ankandit) dhe nje seri pagesash te vazhdueshme (si per shembull tarifa vjetore per perdorimin e spektrit). Dhenia ne perdorim e cmimit fillestar per spektrin 1800MHz.

Operatori 4: Te gjitha licensat e reja per spektrin e alokuar me pare, duhet te jene automatikisht neutrale dhe teknologjike duke lejuar implementimin e teknologjive 3G dhe 4G. Kjo eshte nje praktike dhe politike standarde per spektrin ne BE. Nuk ka baze per pagesen e nje tarife shtese per neutralitetin. Qe te dyja, si tarifa vjetore ashtu edhe pagesa minimale e synuar per perdorimin e spektrit te ri duhet te bazohen ne nivele tarifash te rregulluara sipas nje benchmark-u nderkombetar me modelin e Paritetit te Fuqise Blerese per brezat perkates, duke marre parasysh kushtet specifike ekonomike te Shqiperise. Operoret kane paguar per licensen aktuale te spektrit, nderkohe qe paguajne nje tarife vjetore per te.